



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 389, datë 19.09.2022

PËR

**PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT
{...} NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimet nr. 364, datë 14.09.2021 dhe nr. 373 datë 13.09.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me shkresën nr. 4769/1 prot., datë 14.09.2022, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për periudhën deri më datë 01.07.2023.
2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 20.09.2022.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR